

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndermjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT

dhe

BASHKIMIT TE DHOMAVE TE TREGTISE DHE INDUSTRISE SE SHQIPERISE

Drejtoria e Përgjithëshme e Standardizimit, Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, më poshtë referuar si "DPS" njëra palë,

Bashkimi i Dhomave te Tregtise dhe Industrise se Shqiperise, më poshtë referuar si "BDhTISH", pala tjetër,

duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë që ka bashkëpunimi midis institucioneve te infrastruktures se cilesise dhe atyreve qe merren me zhvillimin ekonomik,

plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë, rolin dhe perfitimet qe rrjedhin nga nje bashkepunim i ngushte midis paleve te interesuara per zhvillimet teknologjike ne fushen e sigurise dhe cilesise se produkteve e sherbimeve,

plotësisht të vetëdijshëm për ndikimin pozitiv që kanë standardet dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit në zhvillimin e ekonomik te vendit dhe në marredheniet tregtare rajonale,

duke synuar nje pjesemarrje aktive ne aktivitetet e fushes se standardizimit,

duke synuar per te çuar me prane biznesit dhe strukturave te zhvillimit rajonal teknologjine me te fundit ne nivel European e Nderkombetar,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Përcaktime të përgjithëshme

1.1 Palët janë dakord të bashkëpunojnë në fushën e standardeve dhe fushave të tjera që lidhen me të:

- BDhTISH – nëpërmjet pjesemarrjes ne Komitetet Teknike (KT) te DPS-s sipas rregullereve dhe procedurave te brendeshme te DPS-s;
- Dhenies se informacionit, duke promovuar në përgjithësi rolin e Standardeve Europiane dhe veçanërisht rolin e Standardeve të Harmonizuara në zbatim të

Direktivave të Afrimit të Ri, lehtësinë që ato krijojnë në zbatimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe në eliminimin e barrierave teknike në marrëdhëniet tregtare; si dhe

- plotësimin e nevojave të biznesit vendas sipas kërkesave të tyre me standarde dhe materiale të tjera të publikuara nga DPS, duke patur në konsideratë të drejtën e Pronësisë Intelektuale të saj dhe parashikimet e Guidës 10 të CEN&CENELEC "*Udhëzues për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve të CEN&CENELEC*", të Guidës 12 të CEN&CENELEC me Anekset e saj, si dhe parashikimet në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.
- DPS – nepermjet takimeve të here pas hereshme me BDhTISH ku të njihet me kërkesat dhe nevojat e bizneseve;
- Trainimeve të stafit të BDhTISH apo të personave të tjerë të interesuar me kërkesë të BDhTISH për fushën e standardizimit apo për standarde të caktuara;
- Dergimit falas në BDhTISH të Buletineve dhe publikimeve të tjera të DPS-s;
- Furnizimin me standarde me destinacion ri-shitjen e tyre sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

2 Perballimi i shpenzimeve

- a) DPS, për trajnimet apo takimet e punës me BDhTISH, kur këto trajnime apo takime behen jashtë qytetit të Tiranës do të mbulojë shpenzimet e veta (si udhëtimi, fjetja dhe dieta) sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet brenda dhe jashtë qytetit, si dhe shpenzimet për të gjitha materialet e aktivitetit, në rastet kur këto inisiativë e merr vete.
- b) Në rastet kur trajnimet apo takimet e punës kerkohen nga BDhTISH të zhvillohen jashtë qytetit të Tiranës, sipas rastit, këto shpenzime do të negocohen me partitë midis paleve dhe do të vendoset mbi bazën e një arsyetimi korrekt dhe të paaneshëm.
- c) Në të dy rastet, kur shihet e mundur, mund të behen edhe ndarje të shpenzimeve midis paleve, gjithnjë me marrëveshje me partitë me shkrim të tyre.
- d) BDhTISH do të ketë përgjegjësinë për të mbuluar shpenzimet e organizimit të veprimtarisë (si e materialeve të nevojshme për veprimtarinë, e ambientit, e paisjeve, e të tjera që lidhen me masat organizative) në rastet kur këto inisiativë e merr vete.
- e) Informacioni dhe/ose njoftimet për shtyp, si dhe materialet e dala nga veprimtaritë e ndryshme, të cilat janë organizuar bashkërisht nga palët, mund të publikohen vetëm mbas diskutimit me palën tjetër dhe vetëm mbas marrjes së parë të miratimit me shkrim nga të dy palët.

3 Përkthimi i standardeve

- a) Me qëllim sigurimin/ ofrimin e nje standardi Shqiptar, i cili ka adoptuar nje standard European (EN) apo nderkombetar (ISO/IEC) ne gjuhen shqipe, BDhTISH-s apo kompanive te ndryshme te interesuara nepermjet saj, palet bien dakord të bashkëpunojnë për përkthimin në gjuhën Shqipe të ketyre standardeve dhe standardeve të tjera të huaja.
- b) Përkthimi në gjuhën Shqipe i standardeve EN, ISO/IEC dhe standardeve të tjera të huaja do të jetë subjekt i një bashkëpunimi të veçantë, ndermjet DPS-s dhe BDhTISH-s. Nese BDhTISH ka kerkesa nga pale te interesuara per të marre nga DPS te përkthyer një apo disa standarde, mund te sponsorizojë DPS per perkthimin e tekstit te ketij standardi nga anglishtja apo frengjishtja ne Shqip. Sponsorizimi i ofruar do te jete i barazvlefshem me çmimet e perkthimeve te materialeve te ngjashme qe ekzistojne momentalisht ne treg.
- c) Ne kete rast, pales se interesuar, e cila ofron sponsorizimin per perkthim, i jepet standardi apo standardet me gjysem çmimi, pra konsiderohet bashkepunetor i DPS-s, dhe ne nje vend te pershtatshem ne faqen e brendeshme te standardit/eve i njihet ky sponsorizim, duke shenuar emrin e personit apo kompanise, e cila ofroi kete sponsorizim per perkthimin e tij/ tyre.
- d) DPS angazhohet të përfshijë si te ftuar personin apo perfaqesues te kompanise sponsorizuese (nese ekziston deshira nga keta te fundit) në Komitetin Teknik perkates, i cili është përgjegjës për përkthimin dhe vlerësimin përfundimtar te tij.
- e) Pas kësaj procedure, DPS ka të drejta të plota për t'i adoptuar këto standarde të përkthyer në Shqip duke i dhene atyre statusin e Standardeve Shqiptare (S SH) nese jane ende te paperkthyer.

4 Pronësia Intelektuale

- a) E drejta e autorit për çdo Standard Shqiptar (S SH) të përkthyer nga Komitetet Teknike të DPS dhe te sponsorizuar nga BDhTISH apo me kerkesa te saj nga pale te interesuara, i mbetet DPS.
- b) Në rastin e shkeljes së të drejtës së saj të autorit, DPS ka të drejtën të vendosi se çfarë veprimi do të ndërmarrë në një rast të tillë, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- c) BDhTISH apo çdo pale e interesuar qe sponsorizon per perkthimin e nje apo disa standardeve Shqiptare nuk do të përfaqësojë DPS dhe nuk do të japë asnjë garanci e cila do të nënkuptonte marrjen e autorësisë për Standardet Shqiptare.

5 Caktimi i BDhTISH si Shitës Zyrtar

- a) DPS cakton BDhTISH si Shitës Zyrtar të DPS për ri-shitjen e Standardeve Shqiptare në qytetin e Tiranës dhe jashtë tij nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi dhe BDhTISH bie dakord që të veprojë në këtë kapacitet, subjekt i parashikimeve dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.
- b) DPS rezervon të drejtën për të shitur Standardet Shqiptare direkt klientëve në qytetin e Tiranës dhe jashtë tij, me kërkesë të paleve dhe vetëm për qëllime përdorimi dhe zbatimimi në praktikë të këtyre standardeve.
- c) BDhTISH do të prezantohet si "Shitësi Zyrtar" i DPS për Standardet Shqiptare.
- d) BDhTISH gjatë shitjes së standardeve nuk do të përfaqësojë dhe nuk do të japë ndonjë garanci apo të veprojë ndryshe nga ato të autorizuar nga DPS në formë të shkruar rast pas rasti dhe gjithashtu BDhTISH do të shmangë DPS-ne nga ndonjë përgjegjësi e ardhur si rezultat i ndonjë garancie apo përfaqësimi të BDhTISH-s të pa-autorizuar nga DPS.
- e) BDhTISH nuk do të shesë asnjë Standard Shqiptar nëpërmjet një agjenti shitjeje ose nën-kontraktori pa lejen me shkrim më parë të DPS-s.
- f) BDhTISH nuk do të marrë Standarde Shqiptare nga asnjë person, firmë apo kompani tjetër veç DPS-s.
- g) BDhTISH nuk do të:
 - themelojë ndonjë degë apo mirëmbajë ndonjë magazine apo arshive për Standardet Shqiptare; ose
 - ndërmarrë asnjë veprimtari promovuese për Standardet Shqiptare jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë;
- h) BDhTISH, si "Shitës Zyrtar" i DPS do t'i bindet plotësisht rregullave të vendosura nga CEN/CENELEC në Guidën 10 të tyre (Udhëzime për shitjen dhe shpërndarjen e publikimeve të CEN/CENELEC) ose të çdo publikimi që zevëndëson atë.

6 Furnizimi i BDhTI me Standarde Shqiptare

- a) Çdo urdhër/porosi për Standarde Shqiptare do të përbëjë një kontratë/urdhër më vehte siç jepet në paragrafin f) më poshtë.
- b) BDhTISH do të kërkojë Standarde Shqiptare nga DPS për qëllime ri-shitjeje operatorëve ekonomikë vendas dhe/ose të huaj që veprojnë në territorin Shqiptar.

- c) BDhTISH do të caktojë një ose dy punonjës të saj, të cilët do të veprojnë bashkë ose veç e veç dhe që do të njihen zyrtarisht nga DPS si personat për të cilët do të printohen dhe jepen për shitje Standardet Shqiptare.
- d) BDhTISH në respekt të çdo kontrate/urdhëri për Standarde Shqiptare do të jetë përgjegjëse për të siguruar saktësinë e urdhërit.
- e) DPS do të sigurojë linjë direkte telefoni fiks, faksi ose e-maili për BDhTISH për të bërë të mundur nga kjo e fundit urdhërimin e Standardeve Shqiptare.
- f) DPS do të konsiderojë të rregullt kërkesën për të blerë standarde nga BDhTISH nëse ajo vjen nga personat e përcaktuar më sipër me telefon në numrat 22 62 55, 23 48 54, 24 71 76, me faks në numrin 24 71 77, me e-mail në adresat e DPS-s si dhe personalisht punonjësve në sektorin e shitjes së standardeve dhe/ose të çdo punonjësi tjetër të DPS-s, kryesisht tek dedja.k@dps.gov.al; mieshova.l@dps.gov.al; nati@dps.gov.al.
- g) DPS do t'i sigurojë BDhTISH-s Standardet e kërkuara brenda 24 orëve, 48 apo 72 orëve në varësi nga numri dhe mënyra e pagesës (siç përshkruhet në dispozitat e mesiperme) së standardeve të kërkuara.
- h) BDhTISH nuk do të krijojë ndonjë magazinë apo arkivë shpërndarjeje për të magazinuar/ruajtur Standardet Shqiptare, të cilat janë të destinuara vetëm për shitje nga ana e BDhTISH në qytetin e Tiranës dhe jashtë tij dhe/ose t'i përdorë ato për ri-shitje.

7 Termat financiare

- a) BDhTISH i detyrohet DPS-s për çdo Standard të kërkuar për shitje 30% të vlerës totale të Standardit/eve dhe 70% e kësaj vlere i mbetet BDhTISH-s. Vlera totale e Standardit/eve bazohet në tarifat më të fundit të miratuara nga Ministria e Financave. Me kërkesë të BDhTISH-s, do t'i sigurojë asaj të gjitha Standardet Shqiptare në format *hard copy*.
- b) DPS do t'i sigurojë BDhTISH-s Standardin/et e kërkuara në momentin e marrjes së pagesës nga BDhTISH (cash në zyrat e DPS-s apo me transfertë bankare të kryer në numrin e llogarisë së DPS-s, Dega e Thesarit, për Drejtorinë e Përgjithëshme të Standardizimit, Banka Raiffeisen, Nr.llogarisë: 0102030780. Pagesat do të kryhen, vërtetohen dhe shoqërohen me faturat përkatëse, konform rregullave financiare në fuqi.

8 Ligji i zbatueshëm

- a) Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për mosmarrëveshjet që nuk zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, shqyrtimi do të behet në gjykatë sipas Kodit të Proçedures Civile.

9 Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

- b) Kjo Kontratë lidhet me afat 1 (një) vjeçar dhe hyn në fuqi ditën që nënshkruhet nga palët. Zgjidhja e saj do të bëhet me njoftimin paraprakisht me shkrim të njëres palë jo më vonë se 2 muaj (dy muaj) nga data e përfundimit të saj ose në rast se konstatohen shkelje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi nga palët.
- c) Marrëdhëniet në këtë Kontratë do të konsiderohen të pazgjidhura nga palët në rast se asnjëra palë nuk do të ketë njoftuar më parë me shkrim palën tjetër për zgjidhje të Kontratës apo për rinovim të saj brenda afatit të përcaktuar në germen b) të kësaj Kontrate.
- d) Çdo shtesë e një akti/rregulloreje tjetër do t'i referohet kësaj Marrëveshjeje Bashkepunimi si një amendim, ri-shpallje apo zgjerim në një kohë të caktuar.
- e) Kontrata është në 2 (dy) kopje të njëjta për secilën palë, e cila është hartuar, kuptuar dhe nënshkruar me vullnetin e mirë e të plotë të palëve nënshkruese.

Për :

**DREJTORINË E PËRGJITHËSHME
TË STANDARDIZIMIT**

ARBEN NATI

Drejtore i Përgjithshëm

Për :

**BASHKIMIN E DHOMAVE TË
TREGTISË DHE INDUSTRISE
SE SHQIPERISE**

ILIR ZHILLA

Kryetar

Datë: 17.04.2008